# Mjedis

| Data | Premtimi | Linku | Screenshot |
|---|---|---|---|
| 25/4/2023 | HYRJA E SHKODRES, PARKU REKREATIV | | <br>Benet Beci<br>April 25 at 8:30 PM ·<br>HYRJA E SHKODRES, PARKU REKREATIV<br>Ky park, i cili gjendet mes Bunës dhe rrugës kryesore hyrëse për në Shkodër, ka një karakter të fortë argëtues për përdorim nga qytetarët dhe kombinon zonat e gjelbra me zonat e pushimit, këndet e lojrave për fëmijë, zonat sportive dhe të piknikut.<br>Kopshtet e pazarit të vjetër janë një ndërhyrje në peisazh që shenjon vendndodhjen e Pazarit të vjetër të Shkodrës duke ofruar një interpretim të rëndësisë historike të tij, jo vetëm për Shqipërine, por për të gjithë Ballkanin. Kopshtet përbëhen nga 30 dhoma që ngjasojnë me 30 rrugicat e pazarit që ishin të ndara sipas zejeve. Gjeometria e këtyre kopshteve është e frymëzuar nga një motiv i veshjeve tradicionale, që është i ekspozuar në Muzeun Historik të Shkodrës.<br>Këndet e lojrave për fëmijë janë të përbëra nga pesë ishuj lojrash dhe kanë programe argëtuese për fëmijët e moshave të ndryshme.<br>Zona e lojrave të tavolinës është e dedikuar për lojrat e shahut, ping pongut e lojrave të tjera të tavolinës për të gjitha moshat.<br>Një vëmendje e veçantë në të gjithë këtë projekt i është kushtuar gjelbërimit; pemët ekzistuese në përgjithësi do të ruhen dhe parku do të pasurohet me bimësi të re që nga pemët e larta, shkurret dhe bimët e ulta. Ky park me një sipërfaqe prej 18 hektarësh, me gjelbërimin e dendur e me hapësirat për shëtitje, vrapim, biçikletë dhe sport, do të jetë një mushkëri e re për qytetin.<br>#shkodrapozitive #shkodraepara |

Revision #1
Created 2023-09-20 13:38:36 UTC by P. P
Updated 2023-09-20 13:39:19 UTC by P. P